

# Akt Themelimi

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Sun Bow” Sh.p.k.

### Neni 1

#### Themelimi

- 1.1. Emri i shoqërisë është “**Sun Bow**” Sh.p.k.”, (ketu me poshte e quajtur “Shoqeria”). Shoqeria është themeluar ne formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ne përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2. Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- 1.3. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

### Neni 2

#### Selia

- 2.1. Selia e Shoqërisë do te jete në adresën: Rruga Korçe-Tirane, km 1, Zona kadastrale 8564, nr pasurise 22/28 Ciflig, Korçe
- 2.2. Shoqeria mund te themeloje dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi brenda teritorrit te Republikes se Shqiperise dhe/ose ne shtete te tjere, ne përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

### **Neni 3**

#### **Objekti**

Objekti i Shoqërisë është si me poshte vijon:

1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Në mënyrë më specifike, aktiviteti bazë i kësaj Shoqërie do të jetë:

Shoqëria do të ketë për objekt kryesor aktiviteti prokurimin dhe punimet e ndërtimit, të tilla si, por jo duke u kufizuar në, studimin dhe projektimin, furnizimin, transportin, dorëzimin, ndërtimin, instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të energjisë së rinovueshme (diellore, eolike, hidroelektrike, biomasës, etj.) dhe të njësive për ruajtjen e energjisë si dhe infrastrukturës së lidhur me to, duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit, etj., si dhe çdo aktivitet ndihmës i lidhur me sa më sipër, si punime gërmimi, punime për sistemimin dhe punime të tjera të tokës, si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import eksport të pajisjeve, riparim dhe mirëmbajtje të materialeve dhe pajisjeve dhe të gjithë aktivitetet e lidhura me këto çështje. Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, ligjor, që lidhet direkt ose indirekt, me objektin e mësipërm dhe që mund të konsiderohet i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet aktiviteti i Shoqërisë.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.


### **Neni 5**

#### **Kapitali Themeltar dhe Ortaket**

5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke (njqindmije leke).

- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 5 (pese) kuota, me vlere te pergjithshme 100.000 leke (njqindmije leke);

2



- të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera.

5.2. Ortaket themelues te shoqerise jane:

Z. Ilir Meçe, me Numer Personal (ID) H10701200A  
Z. Andrea Salillari, me Numer Personal (ID) H31121013N  
Z. Eugen Elezaj, me Numer Personal (ID) H20604044P  
Z. Florant Avdolli, me Numer Personal (ID) G70525078N  
Z. Abaz Aliko, me Numer Personal (ID) G61008024I

5.3. Përgjegjësia e ortakeve shtrihet deri në shumën e kontributit në kapitalin themeltar.

## Neni 6

### Transferimi i Pjeseve

Ortaket nuk kane te drejte te shesin, transferoje, kalojne apo disponojne pjeset e kapitalit ne favor te ndonje pale te trete, pa miratimin paraprak me shkrim te Asamblese se Ortakeve.

## Neni 7

### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise, vendimet e se ciles merren ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e Statutit.

## Neni 8

### Administratori(et)

8.1. Shoqeria administrohet nga 1 (nje) administrator i emeruar nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve.

8.2. Administratori i parë i shoqerise do te jete:

- Z. Andrea Salillari, i datëlindjes 21.11.1973, lindur në Korce dhe banues në Korce, mbajtes i leternjoftimit nr 033858304 dhe nr personal H31121013N.

3

8.3. Administratori do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 (pese) vjecare, me të drejtë riemerimi.

8.4. Shoqëria përfaqësohet ndaj të treta me nënshkrimin e Administratoreve.

## Neni 9

### Viti Financiar

9.1. Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratorët hartojnë pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

9.2. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor të vitit 2024.

## Neni 10

### Te ndryshme

Ky Akt Themelimi është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe secila me të njëjten vlerë.

Korçë, më 22/02/2024

#### ORTAKET THEMELUES

Shir Meçe At  
Andree Salihari  
Eugen Elezri  
Abet Alies D  
Florant Avolli